



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:231921
Datë: 27.12.2023
Numri i dokumentit: 05131877

C-IV.-14-4915

Ankuesi:

Z M, Pejë

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore “Gërmia”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, 27 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 23 qershor 2014, parashtruesi ka dorëzuar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër vendimit nr.PRN093-018 të nxjerrë nga Autoriteti i Likuidimit të AKP-së më 6 qershor 2014.

Parashtruesi deklaroi se që nga viti 2001, nga NSH “Gërmia”, nuk iu ka lëshuar kurrfarë vendimi

tjetër mbi asistencën sociale, por nga data 1 janar 2005 deri më 14 gusht 2007, ka marrë 1.500,75 euro. Andaj, parashtruesi konsideron se kjo është dashtë të vazhdohet deri me dhënien e ndonjë vendimi të ri.

Poashtu, parashtruesi theksoi se refuzimi i kërkesës së tij është bazuar se “ *Parashtruesi i është përgjigjur kërkesës së dërguar nga AL-ja me datën 23 maj 2013, por duke dërguar vetëm vendimin mbi asistencën sociale për vitin 2001, pa paraqitur vendimin e kërkuar për asistencën sociale për periudhën e pretenduar. AL-ja ka ardhë në përfundim se dëshmitë e kërkesës së paraqitura nga kërkuesi kanë mbetur të pa kompletuara, edhe pas kërkesës për dokumentacion plotësues, prandaj kërkesa është refuzuar si e pavlefshme.*

Kësisoj, parashtruesi ka kërkuar nga gjykata rishikimin e vendimit të AKP-së nr. nr.PRN093-018 të nxjerrë nga Autoriteti i Likuidimit të AKP-së më 6 qershor 2014, ashtu që e paditura të bëjë kompensimin e mjeteve të asistencës sociale nga NSH “Germia”.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi për gjykatën ka prezantuar:

- *Kopjen e kërkesës së Likuidimit të filluar me 24 shtator 2007*

Më 21 nëntor 2023, Zyrtarja për Financa i ka dërguar parashtruesit të ankesës vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i cili ka hyrë në fuqi më 01 maj 2017, ose të paraqesë prova që bën pjesë në kategorinë e palëve për t’u liruar nga pagesa e taksës gjyqësore. Parashtruesit të ankesës iu bë me dije lidhur me pasojat juridike nëse në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga data e pranimit të kësaj vërejtjeje nuk e paguan taksën gjyqësore.

Për më tepër, parashtruesi i ankesës është obliguar që ta paguaj taksën gjyqësore për ankesën e parashtruar konform nenit 253.4 të LPK-së. Ankuesi ka pasur mundësi të parashtroj kërkesë për lirim nga taksat gjyqësore.

Pas dështimit të dorëzimit-pranimit të vërejtjes së gjykatës, në bazë të nenit 26, paragrafi 5 i Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme, nenit 116.5 dhe 116.6 të LPK-së, gjyqtarja e urdhëroi Zyrën e Regjistrimit që të afishoj (publikoj) në tabelën e shpalljeve, vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore. Vërejtja e gjykatës qëndroi në tabelën e shpalljeve nga data 18 dhjetor 2023 deri më 26 dhjetor 2023.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.

Sipas nenit 76 par.3 i Ligjit Nr.06-L-086, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë *mutatis mutandis* dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”

Paditësi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Në vazhdim dispozita 253.5 parasheh: “Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas urdhrimit të dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”

Ankuesit i është lejuar afati prej pesëmbëdhjetë ditëve që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor. Ankuesi ka për obligim të paguaj taksat gjyqësore.

Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Gjykata ka shfrytëzuar të gjitha rrugët ligjore për të realizuar dorëzimin e vërejtjes të parashtruesi i ankesës për pagesën e taksës gjyqësore, por një gjë e tillë nuk ka qenë e mundur në adresën e dhënë.

Për më tepër, gjykata me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor ka bërë edhe afishimin (publikimin) e vërejtjes në tabelën e shpalljeve me qëllim të informimit të palës në procedurë për përmbushjen e detyrimit në kuptim të pagesës së taksës gjyqësore.

Parashtruesi është i obliguar që ta njoftojë gjykatën për ndërrimin e adresës së vendbanimit siç parashihet me Nenin 116 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, i cili parasheh që: ‘Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj, gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.’

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në pajtim me nenin 33 paragrafi 1 dhe nenin 36 paragrafi 2 pika 2.3 e Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet gjyqësore:

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja
Manushe Karaçi